

MEMO

<i>Datë:</i> 28. 08. 2020	
Për: Z. Armend Zemaj, Ministër i Shëndetësisë	Nga: Lul Raka Bordi Këshillëdhënës për Covid-19
RAPORT NGA MBLEDHJA E GJASHTË E BORDIT KËSHILLËDHËNËS PËR COVID-19	

PËRMBLEDHJE E QËNDRIMEVE TË BORDIT KËSHILLDHËNËS ANTI-COVID 19

- Të rihapen qendrat për mjekësi fizikale dhe rehabilitim me kapacitete të redukuara dhe me zbatim rigoroz të masave parandaluese.
- Të rihapen kinematë dhe teatrot me kapacitete të redukuara (1/4 deri 1/3) dhe me zbatim rigoroz të masave parandaluese.
- Të fillojë menjëherë punën laboratorit i mikrobiologjisë klinike në QKUK dhe të jetë në shërbim të të gjitha klinikave të QKUK. Ky shërbim duhet të ketë statusin e njëjtë sikurse Laboratori i Biokimisë në QKUK.
- Të merret në konsideratë instalimi dhe përdorimi i sistemeve të ventilimit në klinikat që trajtojnë pacientë me COVID-19.
- Të zbatohet ligji për kujdesin shëndetësor emergjent që mundëson një triazhim më të mirë të pacientëve me Covid.
- Miratohet draft-propozimin për përdorimin e maskave dhe mbulesave të fytyrës.

1. QENDRAT PËR MJEKËSI FIZIKALE DHE REHABILITIM

Qendrat për mjekësi fizikale dhe rehabilitim bëjnë pjesë në kategorinë e institucioneve shëndetsore. Në Kosovë, këto institucione janë mbyllur që nga data 12 Mars 2020. Në pamundësi të shfrytëzimit të kapaciteteve vendore, një numër i madh i qytetarëve tonë I kanë frekuentuar vazhdimisht qendrat simotra në rajon: Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi.

Rekomandimi i Bordit: të rihapen qendrat për mjekësi fizikale dhe rehabilitim me kapacitete të redukuara dhe me zbatim rigoroz të masave parandaluese.

Parandalimi dhe kontrolli i shfaqjes dhe përhapjes së COVID-19 në qendrat për mjekësi fizikale dhe rehabilitim ka rëndësi të jashtëzakonshme, pasi që shumë persona që frekuentojnë në këto institucione janë të cenueshëm për shkak të moshës së tyre dhe sëmundjeve të mundshme bashkëshoqëruese.

Administratorët e këtyre institucioneve duhet të zbatojnë masat e përgjithshme të parandalimit dhe kontrollit (PKI) të COVID-19 të përgatitura nga IKSHPK dhe MSH (maska, distancë fizike dhe higjienë e duarve).

Parimet e parandalimit të infeksionit:

- Procedura e marrjes së të dhënave për pacientët dhe rezervimet të bëhen përmes telefonit.
- Të ndalohen plotësisht vizitat e familjarëve.
- Të shmangët pritja në korridore gjatë kontrollit specialistik.
- Në dhoma nuk do të lejohen më shumë se dy pacientë/klientë (familjarë).
- Personat që nuk janë familjarë të ngushtë në mes vete, të vendosen në dhoma të veçanta me vetëm një person në dhomë.
- Gjatë procesit të terapive fizikale distanca në mes të pacientëve do të zbatohet në mënyrë rigoroz sipas rekomandimeve të IKSHPK-së.
- Në hyrje të secilës sallë do të vendosen dezinfektues. Pas çdo procedure të terapive fizikale të bëhet dezinfektimi i hapësirës.
- Në hapësira të restauranteve nuk do të lejohen të ulen më shumë se dy persona në tavolinë.

- Preferohet testimi PCR, për stafin dhe paraprakisht për klientët.
- Maskat të përdoren gjatë tërë kohës nga stafi dhe klientët , përveç kohës së qëndrimit në bazen.
- Ushqimi të servohet në tavolinë, me qëllim që të shmangen tollovitë gjatë kohës së shujtave.
- Të zbatohet qëndrimi në shtëpi, nëse stafi ose klientët që kanë rezervuar qëndrimin, tashmë kanë simptoma sugjестive për COVID-19.

Masat administrative

- Stafi administrativ të konsultojë dhe krijojë kanale komunikimi me autoritetet lokale, rajonale dhe nacionale shëndetësore në lidhje me masat specifike të rekomanduara në vend për parandalimin dhe kontrollin e COVID-19.
- Të caktohet një anëtar i stafit me orar të plotë për të udhëhequr përgjigjen institucionale ndaj COVID-19 në institucion. Ky person duhet:
 - të ketë njohuri për masat e parandalimit të sëmundjes me kriteret e identifikimit të rasteve të dyshimta në institucion;
 - të jetë përgjegjës për të siguruar që i gjithë stafi të jetë i trajnuar në parandalim dhe kontrollë të infeksioneve, përfshirë distancën fizike (dhe vetë-izolim nëse kanë simptoma) dhe trajnimin në higjienë të duarve dhe atë respiratore;
 - të sigurohet se institucioni ka një numër të mjaftueshëm të pikave për higjienën e duarve;
 - të përditësojë planet në rast se sëmuren anëtarët e stafit apo klientët;
 - Të caktohet një person kontaktues (një infermiere ndërlidhëse) përgjegjës për trajnimin e PKI (përfshirë higjienën e duarve dhe masat parandaluese standarde) për të gjithë stafin.
 - Të sigurohen shenja treguese në të gjitha hyrjet e institucionit që përshkruajnë simptomat e COVID-19.
 - Të sigurojnë që stafi dhe klientët përbrenda institucionit janë duke i zbatuar masat parandaluese.

- Të monitorohen të gjithë klientët çdo ditë për shfaqjen e simptomave eventuale (p.sh. matni temperaturën e trupit).
- Të vendoset xheli alkoolik në dispozicion në çdo dhomë dhe në pikat tjera publike.

2. KINEMATË DHE TEATROT

Rekomandimi i Bordit:

Të rihapen kinematë dhe teatrot me kapacitete të redukuara (1/4 deri 1/3) me zbatim dhe kontrollë rigoroze të masave parandaluese.

PROTOKOLI PËR RIHAPJEN E KINEMAVE (aplikativ edhe për TEATËR)

Distanca fizike:

- Të aplikohet distancë me 2 ulëse të lira për çdo rezervim individual, në mënyrë që njerëzit të mos mund të bëjnë rezervime pa distancën e 2 ulëseve të lira
- Të bllokohet çdo i dyti rresht i ulëseve;
- Distanca fizike mes ulëseve 1.5 – 2 metra;
- Ndarja e familjeve, grupeve deri në 5 persona, çifteve dhe personave individual për të siguruar distancën fizike
- Dalja e vizitorëve nga salla të bëhet nga korridoret emergjentë dhe për sallat ku kjo nuk është e mundur, të aplikohet sistemi i daljes me shirita për t'i nxjerrë vizitorët direkt në qendër.
- Të zbatohet distancë 1.5 – 2 metra për linjat e pritjes në korridorin e qendrës përpara hyrjes në kinema për të blerë bileta dhe produkte, shenjëzim i qartë në tokë.
- Të bëhen pushime 20 minutëshe para fillimit të secilit film, në mënyrë që të mos krijohen rradhë të njerëzve në hyrje të sallave.
- Të ofrohet staf shtesë për të kontrolluar distancën në shiritat e pritjes dhe korridoret e kinemasë.
- Të bllokohen të gjitha ulëset në korridor

- Bartja e maskave për punëtorët e kinemasë të jetë obligative
- Në të gjitha arkat të vendosen 'plexiglass' mbi banak ku qëndron punëtori, ndërsa vetëm pjesa e ngrohësve do të jetë e lirë për t'i shërbyer produktet e blera te klientët.
- Vizitorët duhet të bartin maska në të gjitha zonat dhe t'i mbajnë ato edhe pasi të ulen brenda në sallë.

Ulja e rrezikut të shpërndarjes së Covid-10 në staf dhe vizitorë:

- Dezinfektim i detajuar dhe pastrim i hapësirave të kinemasë para hapjes;
- Pastrim ditor i aparateve dhe dezinfektim i të gjitha sipërfaqeve në kinema;
- Zvogëlimi i numrit të shfaqjeve për të rritur distancën fizike;
- Dezinfektues të duarve në hyrje të kinemasë, hyrje të sallave, tualete dhe në hapësirat e stafit;
- Udhëzime në hyrje të kinemasë për t'ju treguar vizitorëve që pa maska nuk mund të futen në kinema;
- Dezinfektimi i të gjitha sipërfaqeve me kontakt të lartë ndërmjet shfaqjeve;
- Staf shtesë për të dezinfektuar sipërfaqet me kontakt të lartë gjatë tërë orarit të punës;
- Dezinfektim rutinor i të gjitha sipërfaqeve me kontakt;
- Inkurajim i vizitorëve që të bëjnë pagesë pa kontakt, për ta zvogëluar numrin e pagesave me para të gatshme;
- Inkurajim i vizitorëve që të blejnë bileta online përmes aplikacionit të kinemasë në telefon;
- Vizitorët t'i hedhin mbeturinat vetë;
- Para çdo filmi, në ekran të shfaqen rekomandimet/obligimet për vizitorët për mbrojtje ndaj Covid-19
- Ofrimi i ajrit të pastër në mënyre konstante përmes njësive HVAC dhe ndërrimit të vazhdueshëm të filterave në këto njësi;

Përditësimi i politikës për sëmundjet e punëtorëve dhe trajnimi i stafit për Covid-19:

- Të monitorohet rregullisht shëndeti i punëtorëve;
- Të kontrollohen punëtorët për praninë e etheve dhe simptomave tjera para dhe pas përfundimit të orarit të punës;
- Të kontrollohet temperatura me termometër pa kontakt; nëse nuk ka ethe, temperaturë mbi 37.5 °C, ose simptoma tjera të Covid-19 të pranishme, t'u kërkohet punëtorëve që ta monitorojnë dhe raportojnë gjendjen e tyre gjatë orarit të punës.
- Të informohet stafi se kur duhet të qëndrojnë në shtëpi apo kur duhet ta lëshojnë punën për shkak të sëmundjes;
- Të sigurohet një procedurë për t'i kontaktuar autoritetet lokale të shëndetit publik nëse një punëtor diagnostifikohet me Covid-19;
- Të zhvillohen plane për mbyllje të përkohshme të kinemasë për të dezinfektuar thellësisht kinemanë dhe për t'u siguruar që pjesa tjetër e stafit dhe vizitorët të mos infektohen.

3. FUNKSIONALIZIMI I LABORATORIT PËR MIKROBIOLOGJI KLINIKE NË QKUK

Laboratori i mikrobiologjisë klinike përbrenda qendrave universitare klinike është domosdoshmëri e kohës dhe funksionalizimit optimal në diagnozën klinike dhe menaxhimin efikas të sëmundjes së pacientit. QKUK, është ballafaquar me shumë sfida dhe mangësi në lëmin e diagnostikës mikrobiologjike:

- Laboratori i mikrobiologjisë në IKSHPK, i cili ka përmbushur kërkesat diagnostike të klinikave të QKUK nuk ka punuar të shtuneve pasdite dhe të dielave. Në aspektin e menaxhimit klinik të rasteve kjo mangësi është reflektuar sidomos në rastet e sëmundjeve jetë kërcënuese për pacientin, siç janë sepsa ose meningjiti. Alternativa e propozuar prej fillimit të pasluftës që të vendoset një termostat në cilëndo klinikë për kultivimin e mostrave klinike gjatë vikendit nuk është pranuar nga menaxhmentet e QKUK.
- Ka munguar komunikimi efikas mes klinikistëve të QKUK dhe mikrobiologëve në IKSHPK

- Nuk ka pasur anjëherë mikrobiolog në vizitat e kryera nëpër klinikat e QKUK. Kjo komponentë do të ndihmonte në interpretimin e rezultateve laboratorike në korrelacion me gjendjen klinike të pacientit

Mungesa e buxhetit ka qenë një ndër arsyetimet e vendimmarësve për mungesën e hapjes së laboratorit mikrobiologjik. Por, i njëjti buxhet për shërbime mikrobiologjike mund të transferohet nga IKSHPK në QKUK.

Por, me ndihmën e fondeve të Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Ndërkombëtar është siguruar hapësira, pajisjet dhe aparatura përkatëse dhe laboratorit është hapur zyrtarisht në shkurt të këtij viti. Njëkohësisht, QKUK ka rekrutuar stafin e ri, mes të cilëve edhe 3 mikrobiologë dhe laborantë. Javën e kaluar është furnizuar me reagjensë të rinj, të cilët duhet të futen në përdorim.

Objekti i laboratorit është vendosur në Klinikën Infektive. Nga fillimi ka pasur keqkuptime se ky laborator për shkak të hapësirës në klinikën infektive, është thjesht vetëm në shërbim të klinikës infektive. Por, ky laborator duhet të jetë në shërbim të të gjitha klinikave të QKUK-së. Kjo, edhe për faktin se nga struktura e shërbimeve klinike për QKUK, mostrat më të shpeshta kanë ardhur nga Klinika e Neonatologjisë, Mjekimit Intensiv dhe klinikave të kirurgjisë. Klinika infektive ka pasur numër simbolik të mostrave të përpunuara në laboratorët e IKSHPK-së.

- **Rekomandimi i Bordit: Të fillojë menjëherë punën laboratorit i mikrobiologjisë klinike në QKUK. Ky laborator duhet të jetë në shërbim të të gjitha klinikave të QKUK, e jo vetëm të klinikës infektive. Ky shërbim duhet të ketë statusin e njëjtë sikurse Laboratori i Biokimisë në QKUK dhe t'i përgjigjet në organogram direkt Drejtorisë së SHSKUK.**

4. VENTILIMI

Sistemet e ngrohjes, ventilimit dhe klimatizimit përdoren për të siguruar kushte të përshtatshme mjedisore (temperaturë dhe lagështi) dhe ajër të pastër në ambiente të brendshme në institucione shëndetësore.

Ventilimi i dobët në hapësirat e mbyllura të brendshme shoqërohet me rritjen e transmetimit të infeksioneve intrahospitalore. Ka pasur raste të shumta të transmetimit

COVID-19 të shoqëruara me hapësira të mbyllura, duke përfshirë në disa raste personat asimptomatikë dhe presimptomatikë.

COVID-19 transmetohet kryesisht përmes spërklave të mëdha. Por, publikimet e fundit implikojnë edhe rolin e aerosoleve në shpërthimet e COVID-19. Aerosolet përbëhen nga stërpikëza të vogla, të cilat qëndrojnë në ajër për më gjatë sesa spërklat e mëdha.

Filtrat e Efikasitetit të Lartë të Partikulave të Ajrit (HEPA) kanë demonstruar performancë të mirë me grimcat e madhësisë së virusit SARS-CoV-2 (afërsisht 70–120 nm) dhe përdoren në institucione shëndetësore, sidomos ato që trajtojnë pacientë me COVID-19.

Sistemet e ventilimit kanë rol të rëndësishëm në zvogëlimin e transmetimit të SARS-CoV-2 në hapësirat e brendshme duke rritur shkallën e shkëmbimit të ajrit, duke ulur riqarkullimin e ajrit dhe duke rritur përdorimin e ajrit të jashtëm.

- **Rekomandimi i Bordit: të merret në konsideratë instalimi dhe përdorimi i sistemeve të ventilimit në klinikat që trajtojnë pacientë me COVID-19, me tendencë të zgjerimit edhe në hapsirat tjera me rrezik të lartë nga infeksionet spitalore.**

<https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/Ventilation-in-the-context-of-COVID-19.pdf>

https://wwwnc.cdc.gov/eid/article/26/7/20-0764_article

5. LIGJI PËR KUJDESIN SHËNDETËSOR EMERGJENT

Në vitin 2016 Kosova ka miratuar Ligjin për shërbimin mjekësor emergjent, i cili synonte integrimin e shërbimeve emergjente nga ato paraspitalore, spitalore deri tek ato terciare.

Ky ligj kishte për qëllim të rregullonte organizimin, funksionimin dhe financimin e kujdesit shëndetësor emergjent.

Përmes tij synohej të krijohet një Qender Kombëtare e Mjekësisë Emergjente si person juridik, me rëndësi të veçantë shtetërore e cila do të kishte një buxhet të veçantë dhe do të raportonte drejtë në Ministrinë e Shëndetësisë. Kjo qender do të menaxhohej nga

Drejtori Ekzekutiv dhe do të kishte një këshill profesional i cili do ta ndihmonte drejtorin.

Gjithashtu, kjo qender nën vartësinë e saj do të kishte edhe 7 qendra të tjera regionale përmes të cilave do të koordinohet i gjithë aktiviteti në teren.

Si pjesë e riorganizimit është paraparë edhe themelimi një qendre të thirrjeve për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Personeli i Qendrës së thirrjeve sipas protokollit do të duhet të kryente, pranimin e thirrjeve, të jep këshilla telefonuesit, të përcakton nivelin e urgjencës, me rekomandimin e mjekut e udhëzon ekipin në vendin e ngjarjes për intervenim etj.

Edhe pse ky ligj është miratuar në vitin 2016 ende nuk është implementuar. Kujdesi shëndetësor urgjent ende vazhdon të mbetet pjesë e Qendrave Kryesore të Mjekësive Familjare.

Mungesa e implementimit të këtij ligji ka ndikuar edhe në Triazhimin e pacientëve me COVID 19. Kujdesi Urgjent në komuna dhe ai në Spitale nuk kanë komunikim të mirë, prandaj edhe triazhimi I pacientëve ka një potencial të lartë për rrezik jete si rezultat i moskordinimit të duhur.

Rekomandim: Të zbatohet ligji për kujdesin shëndetësor emergjent që mundëson një triazhim më të mirë të pacientëve me Covid.

Rekomandohen SHSKUK dhe Asociacioni i Komunave për zbatimin e këtij ligji që ka të bëjë me triazhimin, referimin dhe transportin e pacientëve nga niveli i kujdesit parësor në atë dytësor dhe tretësor.

6. MASKAT DHE MBULESAT E FYTYRËS

- **Bordi miraton draft-propozimin për përdorimin e maskave.**
- **Bordi, po ashtu, rekomandon që përdorimi i maskave në shkolla të bëhet obligativ prej klasës së gjashtë të shkollës fillore, kurse në mjediset publike prej moshës 12 vjeçare.**

Drafti është bashkangjitur në këtë dokument.

Pjesëmarrës në takim:

Dr. Lul Raka - Kryesues Bordit këshillëdhënës,

Dr. Sanije Xhemajli,

Z. Xhavit Rexhaj,

Dr. Ferid Agani,

Dr. Rukije Mehmeti,

Dr. Isme Humolli,

Z. Xhavit Gashi,

Z. Besim Kodra,

Në takim kanë marrë pjesë edhe dy përfaqësues të OBSH-së;

Dr. Katarina Niward-Infektologe dhe Dr. Mark Katz-Epidemilog klinik.